

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “Zurich”, me seli në Zvicër, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati B.N., kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve-Fondi i Kompensimit me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit (kasko regres) në shumë të përgjithshme prej 5,687.73 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.567/2013 të datës 05.02.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve-Fondi i Kompensimit me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.567/2013 i datës 05.02.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “Zurich” me seli në Zvicër, me të cilën e ka detyruar të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimeve- Fondi i Kompensimit me seli në Prishtinë, që t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 4,051.50 €, në emër të kompensimit të dëmit-kasko regres lidhur me rastin e siguruar të datës 05.08.2011, me kamatë ndëshkuese prej 12% duke filluar nga data 10.12.2012 e deri në pagesën definitive, në afatin partitiv prej 7 ditëve, të gjitha këto nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Ndërsa në paragrafin II të dispozitivit gjykata e shkallës së parë e ka detyruar të paditurën t’ia paguaj shumën prej 1,920.42 €, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve-Fondi i Kompensimit me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, ta ndryshojë ose ta prish dhe lëndën ta kthejë në rivendosje dhe rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në përgjigje në ankesë, paditësi ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr. 567/2013, i datës 05.02.2016, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Kompania e Sigurimeve “Zurich” me seli në Zvicër me datën 21.10.2013 ka parashtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit- Fondi i Kompensimit me seli në Prishtinë lidhur me kompensimin e dëmit në shumë të përgjithshme prej 5,687.73 euro, me kamatë 12%, duke filluar nga data 10.12.2012 në emër të shpenzimeve të riparimit të automjetit, si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datë 05.08.2011. Ndërsa pas marrjes së ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë duke kërkuar ti kompensohet shuma prej 4,051.50euro.

Meqenëse e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadsisë (respektivisht ka pranuar përgjegjësinë për kompensimin e dëmit), por vetëm lartësinë, atëherë gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në konstatimin e ekspertit për vlerësimin e dëmit Nexhmi Shala, të dhënë në ekspertizën teknike të datës 27.08.2014, sipas të cilit konstatim vlera reale e kompensimit të dëmit të pësuar nga i siguruari i paditësit respektivisht kostoja e riparimit të automjetit të dëmtuar është në shumë prej 4,051.50euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë i vlerësoi edhe pretendimet e së paditurës, lidhur me lartësinë e normës së kamatës, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjës si ligj të veçantë pasi që nga neni 382.2 i LMD-së përcaktohet se *“Lartësia e kamatëvonesës është 8%, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”* dhe në rastin konkret vlen parimi *“lex specialis derogat lex gjenerali”* që nënkupton se pa marrë parasysh se çfarë është rregulluar lidhur me kamatëvonesën me normat e përgjithshme të LMD-së në rastin konkret drejtpërdrejtë zbatohen dispozitat e ligjit special respektivisht neni 26.6 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, që përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij,

dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. 87/2016, dt. 25.10.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.